



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 45 Prot

Tiranë, më 22, 01, 2015

VENDIM Nr. 4 datë 15.01.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.1, të datës 15.01.2015, pasi shqyrtoi "Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik në terren" në kuadër të projektit "Ndërtimi i linjës së transmetimit 100 kv Uznovë-Çorovodë, me dalje në N/Stacionin 110/35 kv Uznovë", OST, realizuar nga arkeologe e licensuar Lida Miraj,

VENDOSI:

- I. Të miratojë "Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik në terren" në kuadër të projektit "Ndërtimi i linjës së transmetimit 100 kv Uznovë-Çorovodë, me dalje në N/Stacionin 110/35 kv Uznovë", OST .
- II. Për zonat me potencial arkeologjik të Peshtanit dhe Uznovës të kryhen sondazhe arkeologjike nga subjekt i licensuar dhe raporti i tyre të paraqitet në KKA e rradhës.
- III. Gjatë zbatimit të punimeve të realizohet mbikqyrja e vazhdueshme arkeologjike nga arkeologët e DRKK Berat, në bashkëpunim me arkeologët e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO